

---

**REFERATE E KUMTESA**

---

**MEMLI KRASNIQI  
FLAMUR UKAJ**

**GJENDJA SHËNDETËSORE NË VISET SHQIPTARE  
GJATË LUFTËRAVE OSMANO-AUSTRIAKE  
NË SHEKUJT XVII-XVIII \***

Një nga sëmundjet më shkatërruese dhe me pasoja të rënda demografike për Evropën mesjetare, pa asnjë dyshim, qe murtaja, e cila në “Kontinentin e Vjetër” kishte ardhur nga Kina e largët. Epideminë e murtajës të tipit Bubonik (Limfatik) e përhapnin minjtë e zi të ardhur në Evropë nga kontinenti aziatik, ndërsa nga minjtë të njeriu bartej nga pickimi i pleshtave. Ndryshe kjo sëmundje quhej edhe “Vdekja e Zezë”, emër ky që vinte si pasojë e gangrenës së gishtërinjve, hundës dhe buzëve, të cilat me kalimin e kohës merrnin ngjyrë të zezë. Pikësëpari kjo epidemi ishte pasojë e kushteve të dobëta higjienike, mungesës së kulturës shëndetësore të popullsisë, njohurive të pakta mjekësore dhe masave joadekuate të pushteteve vendore për parandalimin e epidemisë. Në shek. XIV kjo sëmundje shkaktoi me miliona viktima në Evropë duke zvogëluar numrin e popullsisë nga 30-60 %, ndërsa në Kinë numri i popullsisë ra nga 120 milionë në rreth 65 milionë.<sup>1</sup> Një nga format më të përhapura të saj ishte murtaja e mushkërive. Ajo transmetohej lehtë nëpërmjet frymëmarrjes, nga kontaktet e brejtësve me ushqimin dhe kafshët shtëpiake. Kjo tregonte se bakteri i murtajës limfatike me kalimin e kohës kishte pësuar mutacion dhe kishte filluar të përhapet me anë të frymëmarrjes nga personi i infektuar te njeriu i shëndoshë. Masa mbrojtëse kundër epidemisë së murtajës konsideroheshin: pirja e duhanit,

---

\* Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore me temë “Mahmutbegollajt në rrjedhat e historisë”, organizuar nga Universiteti “Hasan Prishtina” (Fakulteti Filozofik, Departamenti i Historisë) dhe Instituti Albanologjik, Prishtinë, më 5 maj 2012.

<sup>1</sup> Mike Baillie, *New light on the Black death: The cosmic connection*, <http://www.sott.net> // (klikuar, më 10.03.2012).

karantina ose izolimi i zonave të infektuara, ndezja e vendbanimeve dhe veshmbathjes së të infektuarve, varrosja në varreza kolektive të dezinfektuara etj. Të gjitha këto masa filluan të merren në Evropë, vetëm në fillim të shek. XVII, çka solli rrallimin e ndjeshëm të kësaj epidemie një shekull më pas.<sup>2</sup> Këtu ndikoi zëvendësimi i shtëpive prej druri, ku minjtë gjenin strehim, me banesa të ndërtuara prej guri dhe materiale të tjera të pavoritshme për brejtësit; ndryshimi i shprehive higjienike dhe pastërtia e rritur në mirëmbajtjen e shtëpive; largimi nga objektet e banimit të kafshëve të vogla, bartëse të këtyre sëmundjeve.<sup>3</sup> Kanë ekzistuar edhe disa forma primitive të vaksinimit kundër murtajës. Kështu në Anglinë e shek. XVII përgatitej një medikament shërues, ku merrej djersa nga viktima e murtajës dhe përzihej me gjakun e një pëllumbi të vrarë, por nuk dihet se si aplikoheshin kjo te personat e shëndoshë, nëse kjo përzierje pihesh apo grithej me këtë përmbajtje personi i shëndoshë apo i sëmurë.<sup>4</sup>

Perandorinë Osmane, epidemia e murtajës filloi ta godasë vetëm në fillim të shek. XVII dhe që nga ajo kohë e deri në shek. XIX, kjo sëmundje vazhdoi të ishte një element shkatërrues i saj.<sup>5</sup> Në burimet osmane ajo njihet me dy emra: taun dhe veba. Me taun quhej murtaja e gjëndrave, ndërsa me veba përfshiheshin të gjitha sëmundjet ngjitëse. Me kalimin e kohës me këtë term u identifikua vetëm murtaja, ndërsa me taun do të emërohej vetëm murtaja e gjëndrave limfatike.<sup>6</sup> Meqenëse sëmundja krahas njeriut godiste edhe kafshët, përhapja thellonte edhe më shumë varfërinë, duke vështirësuar punët bujqësore, lëvizjen e lirë, tregtinë dhe transportin e mallrave. Një nga format preventive kundër saj ishte dezinfektimi i personit të infektuar dhe rrobave të tij, gjë që bëhej nga një përzierje e sulfurit dhe elementëve të tjerë, pastaj shmangia e kontakteve fizike me të sëmurët dhe sendeve të tjera të dyshimta. Por është interesant, se anëtarët e familjes së infektuar vazhdonin të hanin në

<sup>2</sup> Fernand Braudel, *The Mediterranean and the mediterranean world in the age of Philip II*, Vol. II, New York: Harper & Row, 1972, f. 87.

<sup>3</sup> *Po aty*, f. 84.

<sup>4</sup> <http://www.historylearningsite.co.uk> (klikuar, më 12/03/2012).

<sup>5</sup> Latif A. Armağan, Neşe Özden "Proçjene raznih epidemija kuge u Balkanskim i zapadno-anadolskim krajevima Osmanskog Carstva u XVIII stoljeću", *Prilozi*, 35, Sarajevo: Des, 2006, f. 31.

<sup>6</sup> *Po aty*, f. 32.

një tryezë, duke anashkaluar kontaktet fizike, dhe nga gjërat ushqimore vetëm me bukën kishin kujdes të mos e preknin.<sup>7</sup>

Një nga të parët që do të bënte fjalë për këtë lloj sëmundje infektive në viset ballkanike të banuara me shqiptarë, ishte Pjetër Mazreku, i dërguar i Papatit, i cili në vitin 1623-24 do të vizitonte Ballkanin. Ai bënte me dije, se në territoret që sot njihen si Kosovë, kishte plot fshatra shizmatike, ku besimtarët e krishterë katolikë dhe ortodoksë, deri para zyrtarizimit të kalendarit gregorian nga ana e kishës katolike, festonin sipas kalendarit julian festat fetare në të njëjtat ditë.<sup>8</sup> Kjo do të thoshte se deri në këtë periudhë, pra, para reformës gregoriane, dallimet fetare ndërmjet besimtarëve të krishterë katolikë dhe atyre ortodoksë nuk ishin edhe shumë të thella, por se të tilla i bënin elitat politike dhe religjioze ortodokse. Për Prishtinën, Pjetër Mazreku informonte, se qe e banuar shumë prej “turqve” (sigurisht mendohet për popullsinë e islamizuar), të cilët ishin të gjithë timar – spahi të fshatrave. Po sipas tij, aty banonin edhe shumë serbë, kishte 20 shtëpi katolikësh me 100 frymë. Mazreku bën me dije se murtaja që kishte shpërthyer në Kinë, Indi duke ndjekur rrugët tregtare kishte arritur në Evropë dhe zonat ballkanike të Perandorisë Osmane, duke prekur edhe popullsinë e Prishtinës.<sup>9</sup>

Murtajës nuk i kishte shpëtuar as Prizreni, qytete që sipas Kryepeshkopit të Tivarit, Gjergj Bardhi kishte 40 shtëpi katolike, 80 ortodokse dhe 3.000 shtëpi myslimane. Më 29 tetor 1641, Kryepeshkopi informonte Vatikanin se një vit më parë popullsia e qytetit ishte zvogëluar ndjeshëm pasi murtaja kishte marrë jetën e shumë banorëve.<sup>10</sup> Po sipas të njëjtit burim, epidemia kishte prekur edhe Shkupin, Janjevën dhe Novobërdën.<sup>11</sup> Tre vjet më vonë, më 1644, Kryepeshkopi Bardhi evidentonte se në Shkup nuk kishte vendbanim që nuk ishte prekur nga epidemia e murtajës.<sup>12</sup>

Në vitin 1647 nga Prizreni misionari Gërgur Mazreku, nip i Pjetër Mazrekut dhe doktor i filozofisë dhe teologjisë, pos tjerash do të

<sup>7</sup> J. J. Best, *Excursion in Albania*, London: Wm. H. Allen & Co., 1842, f. 202.

<sup>8</sup> Injac Zamputi, *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shek.XVII*, Vëll. I (1610-1634), Universiteti Shtetëror i Tiranës, Tiranë: 1963, f. 337.

<sup>9</sup> *Po aty*, f. 343.

<sup>10</sup> Frrok Zefi, *Skopsko-Prizrenska Nadbiskupija u XVII stoljeću*, Unija zajednica Albanaca u Republici Hrvatskoj, Zagreb: 2006, f. 84.

<sup>11</sup> *Po aty*.

<sup>12</sup> *Po aty*, f. 88.

informonte Kongregacionin e Shenjtë të Vatikanit edhe mbi mënyrat se si banorët e atyre viseve kërkonin shërim nga sëmundjet e ndryshme. Ai do të shpjegonte se në vendbanimet shqiptare të Perandorisë Osmane, të sëmurët praktikonin më së shpeshti të shkonin te fallxhoret, të cilat kryesisht ishin rome ose myslimane. Këto fallxhore, shërimin e bënin duke shikuar letrat dhe pastaj frynin në pjesët e sëmura të trupit.<sup>13</sup> Gjithashtu një nga metodat primitive të vaksinimit, që edhe përdorimi i jargëve të viktimës së murtajës dhe grithja me to, personave të shëndoshë. Këto masa parandaluese janë shenja të një imunizimi primitiv, por jo të praktikuara në mënyrë të përgjithshme dhe të organizuar. Gjithashtu ka dëshmi se murtaja është shfrytëzuar edhe si armë biologjike, në atë mënyrë që në mesin e armikut është hedhur ose lënë kufoma e infektuar nga murtaja.

Në vitin 1679, Perandoria Osmane me nxitjen e Vezirit Kara Mustafë Pashës filloi fushatën ushtarake kundër Perandorisë Austriake, kulmi i së cilës që rrethimi i Vjenës. Po atë vit murtaja e tipit limfatik, e përhapur nga pleshtat e minjve, vrau rreth 80.000 vjenez, ndërsa në 1683 cikli i epidemisë u përsërit.<sup>14</sup> Mirëpo në mars të vitit 1684 fuqitë e krishtera, Austria, Republika e Venedikut dhe Polonia krijuan “Aleancën e Shenjtë” dhe nga luftërat mbrojtëse ato filluan të zhvillojnë luftëra ofensive. Pas dëbimit të ushtrisë osmane nga Austria, si pasojë e humbjes ushtarake, epidemive, por edhe krizës ekonomike, kudo në Perandorinë Osmane shpërtheu anarkia. Në Ballkan, tmerri i popullsisë u bë Jegen Pasha, bejlerbeu i Sofjes, i cili i trimëruar nga dobësimi i autoritetit qeveritar të Portës së Lartë si dhe nga afrimi i ushtrive të krishtera evropiane, u shndërrua në një tiran të tmerrshëm. Pikërisht në këto momente kyçe do të ishte një pasha shqiptar, sipas të gjitha gjasave Mahmut pashë Begolli, ai që me 4.000 ushtarët e tij do të ekzekutonte Jegen Pashën, duke hequr një pengesë drejt unifikimit të burimeve materiale dhe njerëzore të Perandorisë Osmane në përballjen e pritur të saj me austriakët.<sup>15</sup> Më 17 qershor 1689, peshkopi i Nikopolit Stefani i rekomandoi Perandorit austriak sjellje të matur të ushtrisë së tij karshi banorëve të krishterë dhe myslimanë të Ballkanit. Njëkohësisht, ai vinte

<sup>13</sup> *Po aty*, f. 92.

<sup>14</sup> *Great plague of Vienna*, në <http://www.xtimeline.com> (klikuar më 09.02.2012).

<sup>15</sup> Injac Zamputi, Selami Pulaha, *Dokumente të shek.XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*, Vëll. IV (1675-1699), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: 1990, f.164.

në dukje se, ishin të krishterët ballkanas, pra bullgarët, serbët, grekët e shqiptarët, ata të cilët pa përjashtim ishin të etur për plaçkitje midis njëri-tjetrit, por veçanërisht ndaj popullsisë myslimane, të cilën, vijon ai, do të përpiqeshin ta vrisnin krejt.<sup>16</sup>

Në gjysmën e dytë të vitit 1689, ushtritë austriake të udhëhequra nga gjenerali Pikolomini arritën në trevat e sotme të Kosovës. Më 26 tetor 1689 nga gryka e Kaçanikut, austriakët pushtuan Shkupin, të braktisur si nga osmanët ashtu edhe nga banorët, të cilët pos rrezikut të pushtimit ishin larguar edhe nga epidemia e murtajës.<sup>17</sup> Kjo qe edhe një nga arsyet pse Mahmut pashë Begolli me 8.000 ushtarë, nga të cilët kishte shumë serbë dhe shqiptarë, qëndroi larg qytetit.<sup>18</sup> Por është i habitshëm fakti se nuk ka të dhëna mbi numrin e të vdekurve në qytetin e Shkupit dhe, evakuimi i gjithë banorëve nga osmanët krijon dyshime se ndoshta qyteti është infektuar me qëllim prej tyre. Kjo të bën të mendosh se murtaja mund të jetë shfrytëzuar si armë biologjike nga vetë osmanët kundër austriakëve. Qyteti i Shkupit, sipas burimeve austriake, kishte 10-12.000 shtëpi dhe 40 xhami<sup>19</sup>, ndërsa sipas burimeve të Vatikanit ajo kishte 22.000 shtëpi myslimane, 200 shtëpi ortodokse, 150 hebrenje dhe vetëm 9 shtëpi katolike.<sup>20</sup> Të gjitha këto objekte banimi qenë të ndërtuara nga druri, me përjashtim të bazamentit dhe katit të parë që ishin bërë me tulla dhe me gurë.<sup>21</sup> Materiali ndërtimor i shfrytëzuar për ndërtimin e objekteve të banimit ishte shumë i përshtatshëm edhe për brejtësit, minjtë e zi, që ishin bartësit kryesorë të epidemisë së murtajës bufonike apo limfatike. Austriakët, për shkak të "Vdekjes së zezë" e dogjën qytetin, duke besuar se kështu do të eliminonin edhe burimin e epidemisë, pra minjtë që ishin bartësit kryesorë të kësaj sëmundjeje. Armatës perandorake në tërheqje, Kryepeshkopi Pjetër Bogdani i siguroi 6.000 shqiptarë, të cilët së bashku me ushtrinë e Pikolominit hynë në Prizren. Fatkeqësisht, më 9 nëntor të vitit 1689 gjenerali austriak vdes nga murtaja në Prizren dhe pak më vonë, më 6 dhjetor të njëjtin fat pati edhe Pjetër Bogdani në Prishtinë (i cili më vonë do të zhvarroset nga tatarët

<sup>16</sup> *Po aty*, f. 182-183.

<sup>17</sup> *Po aty*, f. 258

<sup>18</sup> *Po aty*, f. 259.

<sup>19</sup> *Po aty*, f. 230.

<sup>20</sup> F. Zefi, *Skopsko-Prizrenska Nadbiskupija ...*, f. 86.

<sup>21</sup> I. Zamputi, S. Pulaha, *Dokumente të shek.XVI-XVII ...*, f. 261.

dhe turqit dhe kufoma e tij do t'u hidhet qenve).<sup>22</sup> Kjo sëmundje ishte edhe një fatmirësi për osmanët, sepse pasardhësi i Pikolominit, hercogu i Hollshajtinit me sjelljet e tij nxiti urrejtjen e aleatëve të djeshëm, pra të shqiptarëve, të cilët filluan të kalojnë në anën e Mahmut pashë Begollit.<sup>23</sup> Dëshmi plotësuese mbi rolin që pati sëmundja e murtajës në konfliktin austro-osman është edhe kronika e myftiut të Prizrenit, Tahir Efendiut nga familja Rrotlla, i cili më 1874 theksonte se një numër i madh i banorëve të qytetit në atë kohë kishin vdekur nga epidemia e murtajës dhe një numër i madh i tyre qenë varrosur në qytetin e Elbasanit ku ishin strehuar si refugjatë.<sup>24</sup>

Murtaja shpërtheu përsëri në vitin 1699 tashmë në kadillëkun e Karadakut, Qystendilit dhe në sanxhakun e Manastirit.<sup>25</sup> Mirëpo përkundër të gjithave, edhe gjatë shek. XVII, qytetërimi osman në fushën e shëndetit dhe pastërtisë publike kishte akoma përparësi ndaj qytetërimit evropian, duke ndërtuar në çdo qendër urbane banja publike "Hamama". Këtë e dëshmon edhe Osman Aga i liruar më 1699 nga robëria austriake, i cili shprehet se sa shumë qe i gëzuar që më në fund do të mund të shfrytëzonte banjat e tilla në Perandorinë Osmane.<sup>26</sup>

Se çfarë pasojash kishin epidemitë e ndryshme në demografinë e përgjithshme të zonave të goditura nga këto sëmundje, tregon sërish rasti i Osman Agës, të cilit nga dy martesat me 11 fëmijë,<sup>27</sup> i kishin mbijetuar vetëm katër fëmijë ose 35 % e të lindurve. Kur kësaj i shtojmë edhe numrin e të vdekurve nga murtaja, mundemi lirisht të themi se në këtë periudhë kohore, në pjesën ballkanike të sunduar nga osmanët, edhe nëse nuk kemi një rënie të ndjeshme të numrit të popullsisë, është e dukshme një reduktim natyral i banorëve, si dhe lëvizje e popullsisë nga zonat malore më pak të prekura nga epidemitë në mjediset urbane të rralluara nga sëmundjet ngjithëse. Është me rëndësi të theksohet se numri i hebrenjve të vdekur nga epidemia e murtajës sipas shënimeve statistikore qe i vogël. Arsyen duhet ta kërkojmë tek rregullat e ashpra religjioze sa i

<sup>22</sup> Ibrahim Rugova, *Vepra e Bogdanit 1675-1685*, Prishtinë: Rilindja, 1982, f. 34-35.

<sup>23</sup> Anton Berisha, *Kosovo nekad i sad - Kosova dikur dhe sot*, Beograd: Borba, 1973, f. 142-143.

<sup>24</sup> Nehat Krasniqi, *Kontribute Albanologjike*, Instituti Albanologjik, Prishtinë: 2011, f. 103.

<sup>25</sup> L. A. Armağan, N. Özden, "Proçjene raznih epidemija...", f. 37.

<sup>26</sup> F. Braudel, *The Mediterranean .....*, f. 286.

<sup>27</sup> *Po aty*, f. 91.

takon higjienës. Gjithashtu ata nuk pinin ujë nga pusët publike dhe për më tepër jetonin në zona të izoluar të qyteteve. Kjo na bën të mendojmë se murtaja, që deri në shek. XVII nuk e kishte goditur fort Perandorinë Osmane, pjesërisht mund të kishte qenë edhe rezultat i religjionit islam, që në çështjet e pastërtisë personale, ishte identike me atë të hebrenjve, pra kërkonte pastërti personale nga besimtari. Në antitezë, kultura higjienike e shtresës së ulët evropiane që e ulët, prandaj edhe murtaja shumë herë përcaktohej edhe si sëmundje e të varfërve. Kjo sepse pjesa më e madhe e banorëve të qyteteve jetonin në kushte të mjeruara higjienike, ndërsa të pasurit edhe mund të largoheshin nga zonat e goditura nga epidemia. Por kjo situatë do të ndryshojë në shek. XVII, kohë kur Evropa filloi të ringrihej moralisht, ekonomikisht, pra edhe në aspektin e shëndetit publik, fushë në të cilën u bënë përparime të mëdha, ndërsa në lindje filloi rënia e Perandorisë Osmane.

Në fillim të shek. XVIII epidemitë e murtajës që shpërthyen në Perandorinë Osmane, pikë së pari kaplonin qytetet-porte të rëndësishme, të cilat ishin vendbanime të mbipopulluara dhe arterie të rrugëve tregtare. Aty murtaja merrte përmasa të mëdha, ngase në këto vendbanime ekzistonin kushte të mjera sanitare, rrjedhimisht ajo edhe godiste shtresat më të varfra të popullsisë. Dëshmi të pranishëm të kësaj sëmundjeje dhe pasojave demografike e ekonomike për Portën e Lartë gjatë shek. XVII-XVIII, janë edhe kujtimet e një francezi, i cili në vitin 1766 do të shkruajë "...ata [osmanët] edhe pse nuk e kanë mjekësinë e zhvilluar si ne, jetojnë po aq gjatë sa ne, nëse shpëtojnë nga murtaja që vazhdimisht e shkatërron perandorinë e tyre".<sup>28</sup> Prezencën e pandërprerë të "Vdekjes së zezë" në Ballkan edhe në këtë periudhë e dëshmojnë raportet e shumta të kryepeshkopëve shqiptarë të Shkupit dërguar Vatikanit. Kështu Mikel Suma kryepeshkop i kësaj dioqeze që nga viti 1728, do të informonte për përmasat e mëdha të kësaj epidemie vdekjeprurëse, nga e cila edhe vetë ishte infektuar në qytetin e Nishit, por që çuditërisht i kishte mbijetuar. Të gjitha këto informacione vijnë nga një mbishkrim i një pikturë që sot ruhet në Kroaci në muzeun e Osjekut.<sup>29</sup>

100 vjet më vonë, më saktësisht në shtator 1781, organet shëndetësore në Kotorr do të lajmëroheshin për shpërthimin e epidemisë

<sup>28</sup> *Po aty.*

<sup>29</sup> Gasper Gjini, *Skopsko Prizrenska biskupija kroz stoljeća*, Zagreb: Kršćanska sadašnjost, 1986, f. 189.

së murtajës në Prishtinë, në provincën shqiptare, siç edhe prezantohet në raport. Natyrisht për të parandaluar përhapjen, Republika e Venedikut do të ndalonte qarkullimin tokësor dhe detar në të gjitha tokat shqiptare.<sup>30</sup> Një nga mënyrat e përhapjes së sëmundjes ishin mallrat tregtare që në Herceg-Novu dhe Split importoheshin nga provincat ballkanike osmane, siç ishte p.sh. pambuku që importohesh më së shumti nga Prishtina, por edhe nga zonat e tjera të Perandorisë Osmane. Rrjedhimisht për të parandaluar epideminë kishte nevojë për kontrollim të anijeve që transportonin mallra nga regjionet e infektuara.<sup>31</sup> Në raportet venedikase theksohej numri i lartë i të vdekurve në regjionin e Prishtinës, sikundër evidentohesh dhe fakti që kjo epidemi nuk ishte përhapur në zonat e tjera, çka na jep të mendojmë se kontaktet ndërmjet zonave të ndryshme ishin të kufizuara dhe qarkullimi i brendshëm tregtar nuk ishte shumë i zhvilluar. Po kështu, në raportet me karakter sanitar të cilat gjenden në Arkivin e Kotorrit, bëhet me dije se kjo epidemi kishte ardhur nga lindja në Selanik, Sofje, Shkup dhe në Prishtinë, ku e kishte sjellë një tregtar osman. Në këto raporte bëhet me dije se organet qeveritare osmane nuk merrnin masat e duhura për të parandaluar përhapjen e epidemisë, ashtu siç vepronin venedikasit. Kështu të gjithë ata qytetarë të Prishtinës që kishin ikur në fshatrat e afërt, vetëm sa kishin ndihmuar në shpërthimin e epidemisë. Ndërsa në Gjakovë edhe pse pati 2 raste të murtajës apo si quhet në dokumentet venedikase, "Maligna influenza" (Grip, ftohje malinje), duke i izoluar dhe penguar kontaktet me banorët e tjerë, arritën të pengojnë shpërthimin e epidemisë.<sup>32</sup> Bëhej fjalë për murtajën e mushkërive, e cila përhapej nëpërmes frymëmarrjes dhe manifestohej me kollitje të përgjakur, dhimbje koke, temperaturë, pneumoni, që brenda 3-7 ditëve sillte vdekjen e të sëmurit. Meqë një nga masat e para preventive kundër epidemive, pra edhe të murtajës ishte karantina ose izolimi, Perandoria Austriake në shek. XVIII do të vendosë midis saj dhe Perandorisë Osmane të ashtuquajturin "Cordon Sanitaire".<sup>33</sup> Në këtë periudhë në Gjakovë ka jetuar dhe vepruar Gjon Nikollë Kazazi (1702-1752), kryepeshkopi i Shkupit si dhe zbuluesi i librit në gjuhën shqipe

<sup>30</sup> Slavko Mijušević, "Pojava kuge u Prištini 1781 godine i reagovanje sanitetskih vlasti u Boki, Zadru i Veneciji", *Vjetari*, Vëll. II-III, Arkivi i Kosovës, Prishtinë: 1970, f. 110.

<sup>31</sup> Po aty, f. 112.

<sup>32</sup> Po aty, f. 115.

<sup>33</sup> L. A. Armağan, Neşe Özden, "Proçjene raznih epidemija ...", f. 34.

“Meshari”. Ai është autori që ka lënë shënime mbi përballjen e suksesshme të banorëve të Gjakovës me epideminë e murtajës. Pikësëpari nga Pashtriku, deri brenda Drinit, nga Nënshkëlzeni e deri te Lumbardhi i Deçanit, u shpall karantina. Më tej banorët u imunizuan me dregëzat e nxjerra nga hunda e të sëmurit dhe pastaj të grithjes së dorës dhe fërkimit me gjakun e banorëve të painfektuar.<sup>34</sup> Kuptohet se kjo luftë kundër epidemisë së murtajës kishte karakter lokal dhe përvoja pozitive nuk shfrytëzohej në zonat e tjera të goditura nga kjo sëmundje.

Shembull i mirë i të dhënave statistikore, nga ku mund të shihet ndikimi i murtajës në rënien demografike të popullsisë, janë të dhënat e kishës katolike. Sipas tyre në provincën osmane të Bosnjës në vitin 1807, kishte 114.391 besimtarë katolikë, ndërsa në periudhën kur bie kjo sëmundje epidemike më 1815-18, numri i popullsisë katolike bie në 50.929 banorë.<sup>35</sup> Burimet arkivore osmane bëjnë gjithashtu me dije se edhe në kohën kur mytesarif i Sanxhakut të Shkupit ishte Maliq Pasha, pra që në vitin 1816, në Vuçiternë dhe rrethinat e saj, kishte shpërthyer murtaja dhe, si pasojë e numrit të madh të të vdekurve, ishin ulur në masë të konsiderueshme të ardhurat shtetërore nga tatimet.<sup>36</sup> Pra, një element shtytës i thellimit të mëtejshëm të antagonizmave sociale në kadillëkun e Vuçiternës, Prishtinës dhe të Novobërdës, padyshim ishte edhe rënia e numrit të tatim paguesve si pasojë e drejtpërdrejtë e epidemisë së murtajës.

Nga sa më sipër, mund të përfundojmë se, murtaja solli rënien numerike të popullsisë kudo ku shpërtheu, duke nxitur lëvizjen apo migrimin e banorëve nga zonat e infektuara në pjesë të tjera. Shembuj të tillë na afron edhe Norman F. Cantor në librin e tij “In the wake of plague”, në të cilin ai shpjegon se një nga shkaqet e emigrimit të hebrenjve nga Evropa Perëndimore për në vendet baltike dhe Rusi, pa dyshim ishte epidemia e murtajës.

---

<sup>34</sup> *Murtaja e vitit 1747 - Nga ditari i Gjon Nikollë Kazazit*  
<http://www.http://www.forumishqiptar.com/> (klikuar, më 15.05.2015).

<sup>35</sup> *Od podjele Provincije do Biskupa Miletiča (1757-1831)*,  
<http://www.bosnasrebrena.ba> (klikuar më 15.05.2015).

<sup>36</sup> *Osmanlı Arşiv Belgelerinde Kosova Vilayeti*, İstanbul: Başbakanlık Devlet Arşivler Genel Müdürlüğü, 2007, f. 123.

